



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.15.1-2018-08

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E SUHAREKËS
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Naser Arllati, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqës Ekipi, Igballe Halili dhe Anëtarëve, Abdurrahmon Bërbatovci dhe Arnisa Aliu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Qeverisja e mirë	25
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA.....	33
Shtojca II: Letër konfirmimi	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Suharekës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 15/01/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Suharekës.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

Nga kategoria e investimeve kapitale, ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht vlera prej 363,599€ që për nga natyra janë mallra/shërbime. Po ashtu, pagesat përmes vendimeve gjyqësore prej 16,841€ janë shpenzuar në kategori jo adekuate, këto shpenzime nuk ishin të buxhetuara.

Komuna nuk ka arritur që të ketë regjistra të plotë për pasuritë jo financiare në sistemin e-pasuria.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi. Çështjet e theksuara në opinionin e auditimit ishin për shkak se klasifikimi i disa shpenzimeve nuk ishte në kategori adekuate si dhe pasuritë nuk ishin të regjistruara të gjitha në sistemin e e-pasurisë.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve për vitin 2019 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih theksimin e çështjes në opinionin e auditimit).

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, përfshirë të hyrat, shpenzimet, të arkëtueshmet si dhe pasuritë jo financiare.



Kryetari duhet të sigurohet se është kryer një vlerësim i detajuar në fushat brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për përsëritjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih kapitullin 3).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial duhet të përmirësohen.



Kryetari duhet të sigurohet se çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithëshme duhet të adresohen me një përgjegjësi dhe kujdes të shtuar (shih kapitullin 4).

Procesi i veprimeve për hartimin e planit të veprimit, rekomandimet kyçe nuk po adresohen siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih kapitullin 5).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën qëi konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen se:

- Në emër të projektit “Funksionalizimi i infrastrukturës për vitalizimin e projektit shtetërit shtëpiak në Suharekë” - (Home Care 2018)¹, komuna kishte buxhetuar dhe ekzekutuar pagesa gabimisht nga kodi i investimeve kapitale në vlerë totale prej 165,621€², të cilat i përkasin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, në shtatë pagesa tjera në vlerë 197,978€³ ishin ekzekutuar nga kodi i investimeve, të cilat i përkasin mallrave dhe shërbimeve si: material shpenzues, blerjet nën 1000€, dekorimi i qytetit për festa dhe shërbimet për mirëmbajtje të rrugëve. Këto pagesa janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht në kategori ekonomike jo adekuate; dhe

Ndërsa në tre (3) raste pagesat për vendime gjyqësore në vlerë totale prej 8,211€⁴, ishin paguar nga kategoria e mallra dhe shërbim dhe investime kapitale ndërsa janë të natyrës së pagave dhe mëditjeve. Në një rast tjetër pagesa për vendime gjyqësore është paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndërsa i përket investimeve kapitale në vlerë 8,630€ (ndërtimi i rrugës). Këto pagesa nuk janë buxhetuar në kategori ekonomike adekuate.

- Komuna nuk ka arritur që t’i regjistrojë të gjitha pasuritë jo financiare në sistemin e e-pasurisë. Pasuritë e blera deri në vitin 2009 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasurisë, në vlerë 1,561,413€ (vlera historike e tyre), por vetëm në një listë të brendshme të komunës (regjistër në Excel).nuk kemi mundur të verifikojmë këtë pasuri meqenëse komuna nuk ka ofruar dëshmi të prejardhjes së saj apo vlerës. Mbajtja e të dhënave në Excel, nuk ofron siguri të plotë për shkak të humbjes apo fshirjes së të dhënave si dhe për shkak se zhvlerësimi i pasurisë bëhet në mënyrë manuale. Mirëpo, gjatë auditimit kemi vërejtur se komuna ka formuar komisionin për identifikimin e tyre (me dokumentet mbështetëse). Këto pasuri, ishin të përfshira në pasqyrat financiare vjetore. Në anën tjetër, pasuritë mbi 1000€ ishin mbi vlerësuar për 43,325€⁵.

¹ Marrëveshja kishte objektivë: përmirësimin e shërbimeve shëndetësore shtëpiake, për të gjitha familjet me gjendje të rënd shëndetësor edhe ekonomike (familjet që kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore permanente, persona të sëmur dhe të moshuar në familje). Më tutje, marrëveshja kishte objektivë edhe ngritjen e shërbimeve shëndetësore në nivel ambulator, për të funksionalizuar punët shëndetësore në zonat rurale si dhe në qendrat e vendbanimeve të mëdha.

² Tetë pagesa në vlerë totale 165,621€ për “Transfere kapitale, entiteti jo publike”.

³ Pajisje për kabinet - Mjete konkretizimi” në vlerë 30,000€, “Investime në vijim-dekorimi i qytetit” në vlerë 16,800€, “Mirëmbajtja investime” në pesë pagesa në vlerë totale 151,173€.

⁴ Vendim gjyqësor në vlerë 2,183€, vendim gjyqësor në vlerë 1,171€, vendim gjyqësor në vlerë 4,856€, vendimi gjyqësor në vlerë 8,630€.

⁵ “Pajisje tjera”, katër pagesa në vlerë totale 40,421€, dhe “Kompjuterë”, dy pagesa në vlerë totale 2,904€, këto pagesa i përkasin blerjeve nën 1000€.

Sipas komunës klasifikimi kishte ndodhur si pasojë e mungesës së buxhetit në kategoritë përkatëse dhe se këto shpenzime janë si pasojë e obligimeve të mëhershme të bartura. Megjithatë, kjo është e ndikuar edhe nga dobësitë në planifikimin buxhetorë. Në anën tjetër, nga menaxhimi jo i duhur i pasurisë, regjistrat e pasurisë ende janë sfiduese për komunën.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 (Shpenzimet Publike) dhe 02/2013 (Menaxhimi i pasurisë);
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë: raportet tremujore, raportet e faturave të papaguara, planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara publike.

Nga aspekti i cilësisë, draft PFV-të fillestare kanë pas nevojë të korrigjohen për shkak se përmbanin disa gabime dhe mangësi informatash. Ato janë korrigjuar, me përjashtim të çështjeve të pasurive dhe keq klasifikimit për të cilat çështje kemi theksuar opinionin. Për më shumë, shih nënkaptullin 2.1 Opinioni i auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve të korrigjuara në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjeve të përmendura në opinion e auditimit të cilati kemi konsideruar jo materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendur jepen rekomandimet:

Rekomandimi C1 ⁶Kryetari duhet të siguroj që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën, të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike. Po ashtu, të konsideroj si prioritet çështjen e menaxhimit të pasurisë, përkatësisht regjistrimin e plotë të pasurisë, e cila do të reflektohet drejt edhe në paraqitjen e PVF.

⁶ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e rej Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi ka të vendosur sistem të mirë të kontrolleve në raport me obligimet statutores të saj. Kontrollat mbi pagat dhe subvencione në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, edhe me tutje mbesin disa fusha të cilat kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollat mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: proceset e prokurimit, klasifikimi adekuat i shpenzimeve, menaxhimin e pasurive dhe llogarive të arkëtueshmeve. Përveç kësaj nevojitet një përqendrim më i shtuar i komunës në parandalimin e ekzekutimit të pagesave direkte nga thesari.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁷	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	15,350,772	17,172,042	16,307,057	13,606,775	12,773,770
Granti i Qeverisë -Buxheti	13,190,911	14,222,771	14,176,544	11,707,336	11,384,240
Të bartura nga viti parapraks	-	694,938	526,389	682,570	221,439
Të hyrat vetjake ⁸	1,988,863	1,988,863	1,456,155	1,183,517	1,164,855
Donacionet e jashtme	-	83,115	83,068	-	3,236
Financimi nga Huamarrja	170,998	182,355	64,901	33,352	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,821,270€. Kjo rritje është rezultat i Vendimit të Qeverisë 1,100,000€ për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, të hyrave e bartura nga viti paraprak 694,938€, nga donacionet e jashtme në vlerë 83,115€; nga huamarrjet për

⁷ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁸ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁹ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

drejtorin e arsimit dhe shëndetësisë në vlerë 11,357€, si dhe zvogëlimi nga shkurtimeve buxhetore për pagave dhe mëditjeve në vlerë 68,140€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 16,307,057€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2017. Kjo konsiderohet një performancë e mirë e ekzekutimit buxhetor.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	15,350,772	17,172,042	16,307,057	13,606,776	12,773,770
Pagat dhe Mëditjet	8,322,431	8,254,291	8,174,021	7,921,189	7,940,567
Mallrat dhe Shërbimet	1,507,185	1,551,359	1,375,493	1,028,221	965,003
Shërbimet komunale	262,000	267,272	244,473	211,604	249,143
Subvencionet dhe Transferet	280,999	1,283,679	1,278,201	278,401	298,137
Investimet Kapitale	4,978,157	5,815,441	5,234,869	4,167,361	3,320,920

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Për kategorinë paga dhe mëditje, kishte zvogëlim të buxhetit në vlerë 68,140€ si pasojë e shkurtimeve buxhetore (mos aplikimi i përvojës së punës prej 0.5%);
- Te kategoria mallra dhe shërbime kishte rritje totale në vlerë 44,174€ nga të hyrat e bartura në vlerë 37,407€ dhe nga financimi i huamarrjeve në vlerë 6,767€. Ndërsa buxheti për komunalë ishte rritur nga të hyrat e bartura në vlerë 5,272€;
- Te subvencionet dhe transferet kishte rritje për 1,002,680€, për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në vlerë 1,000,000€ (Vendim i Qeverisë) dhe nga të hyrat e bartura në vlerë 2,680€; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale kishte rritje në vlerë totale 837,284€, rritja e buxhetit është për sanimin e dëmeve në vlerë 100,000€ (Vendim të Qeverisë), nga të hyrat e bartura në vlerë 649,626€, nga grantet për shërbime publike dhe emergjente në vlerë 83,068€ (Qeveria Zvicerane- Demos) dhe nga financimi i huamarrjeve në vlerë 4,590€.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat vetanake administrohen dhe arkëtohen nga vetë administrata komunale, ku si qëllim kryesor është shpenzimi i tyre për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarin. Të hyrat vetanake, janë burime të rëndësishme të të ardhurave komunale.

Të hyrat e arkëtuara nga komuna në 2018 ishin në vlerë 1,581,633€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznes

ore, të hyrat nga qiraja etj. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e policisë, gjobat dhe nga agjencia e pyjeve në vlerë totale 221,882€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,988,863	1,988,863	1,581,633	1,532,604	1,786,172
Totali	1,988,863	1,988,863	1,581,633	1,532,604	1,786,172

Për vitin 2018, komuna, ka arkëtuar 80% të te hyrave të planifikuara. Krahasuar me vitin paraparak 3% më shumë, ka pasur rritje.

Çështja C2 - Dobësitë në menaxhimin administrativ të tatimit në pronë

Gjetja Sipas rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme të vitit 2015 (neni 1), tatimpaguesit faturohen sipas zonave. Edhe këtë vit kemi identifikuar se nga 10 raste, tre prej tyre, tatimpaguesit nuk ishin faturuar sipas zonave, respektivisht rregullores. Faturimi i tatimpaguesve jo sipas rregullores/ zonave mbivlerëson apo nënvlerëson planifikimin e duhur të te hyrave nga tatimi në pronë.

Sipas zyrtarëve, mos përditësimi i sistemit ka ndodhur meqë nuk është azhurnuar me kohë sistemi me rregulloren. Komuna ka bërë kërkesë në MF- departamentin e tatimit në pronë që të azhurnohet sistemi konform rregullores dhe ligjit të tatimit në pronë, kështu që kjo situatë është në proces dhe pritet nga MF-departamenti i tatimit në pronë t'i bënë përmirësimet e kriterëve sipas zonave, me që ishte rekomandim nga viti i kaluar.

Rreziku Mangësitë e identifikuar ndikojnë në vlerësimin jo të saktë të te dhënave në sistemin e tatimit në pronë, e cila njëkohësisht reflekton edhe tek arkëtimi i te hyrave të komunës dhe realizim më të ulët të projekteve që priten të financohen nga të hyrat komunale.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të rishikojë funksionimin e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar, që të përditësohet me kohë sistemi nga zyrtaret e tatimit në pronë në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, që të dhënat në sistem lidhur me tatimin në pronë të azhurnohen të vlerësohen dhe menaxhohen bazuar në rregulloren e tatimit në pronë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Financave. Gjatë vitit 2018 janë shpenzuar 8,174,021€ për paga dhe shtesa, me një realizim prej 99% e asaj që është planifikuar të realizohet.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, si dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 1,769,185€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 1,619,966€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja A1 - Pranimi i mallit jo sipas rregullave

Gjetja Rregullorja MF- nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 8 citon se pasuritë jo financiare të pranuar janë në përputhje me kontratën dhe urdhër blerjen dhe të dokumentohen me procesverbal, kurse në përbërje të komisionit të pranimit duhet të jetë edhe një anëtar ekspert i fushës përkatëse.

Nga testimi i pagesës në vlerë 2,732€, kemi identifikuar se në specifika të kontratës ishte paraparë të pranohen 9 llaptop. Nga ekzaminimi fizik që kemi bërë, kishte vështirësi të evidentohen se çfarë llaptop janë pranuar, meqë në faturë, fletë dërgese dhe raportin e pranimit nga komisioni, nuk ishin specifikuar numrat serik të llaptopëve të pranuar.

Për pranimin e furnizimeve mjekësore ishte përgatitur vendimi për formimin e komisionit sipas Rregullës Financiare nr.01/2013/MF (shpenzimi i parave publike (neni 23), megjithatë, gjatë auditimit të tri pagesave në vlerë 38,231€ mungonte raporti për pranimin e mallit nga komisioni. Megjithatë, mallrat ishin pranuar nga depoisti.

Kjo kishte ndodhur si pasojë se në fletë dërgese/faturë nuk ishin identifikuar numrat serik për të identifikuar se llaptopët e pranuar janë në pajtim me specifikat dhe çmimet e kontraktuara. Ndërsa mos përgatitja e raportit për pranimin e mallit nga komisioni kishte ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e komisionit.

Rreziku Mungesa e pranimit të furnizimeve nga zyrtarë të fushës së teknologjisë informative dhe mos përgatitja e raportit për mallrat e pranuar, rritë rrezikun që të pranohen furnizime të cilësisë jo të mirë dhe në kundërshtim me kushtet e kontraktuara.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se, mallrat të cilat duhet të jenë të identifikuar me numër, serik, të përfshihen në fletë dërgesë/faturë dhe specifikat tjera të domosdoshme, për tu siguruar se është pranuar malli në pajtim me specifikat dhe çmimet e kontraktuara. Po ashtu të sigurojë se në përbërje të komisioneve të caktohet edhe ndonjë anëtarë ekspertë për fushën përkatës dhe komisionet të përgatisin raporte për pranimin e mallit.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,283,679€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 1,278,201€ apo 99%. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me shpenzimet për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,815,441€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 5,234,869€ apo 90%, që kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale.

Çështja A2 - Ndryshimet për pozicionet e caktuara në realizimin e projektit

Gjetja Sipas RRUOP, pika 61.22 citon se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe sipas pikës 61.23 ndryshimet e kontratës nuk mund t'i lëshohen OE pa aprovim të kryetarit.

Te projekti "Ndërtimi dhe renovimi i objekteve sportive dhe kulturore" në vlerë 47,247€, gjatë realizimit të punëve (fusha sportive) ka pasur ndryshime nga pozicionet e parapara me projekt. Megjithatë, çmimi në total i kontratës nuk është tejkaluar. Ndryshimi i pozicioneve ishte bërë për shkak se fillimisht nuk ishte bërë paramasa e duhur, po ashtu edhe nuk ishte marrë pëlqimi paraprak nga banorët para se të përgatitet paramasa.

Si pasojë, sipas kërkesave të banorëve, është dashtë të ndërrohen pozicionet, ndonëse vlerat nuk janë materiale, procedurat e ndryshimeve janë vendosur jo përmes prokurimit dha aprovimit.

Rreziku Ndryshimet nga specifikat e kontratës, mund të ndikojnë që punët në realizimin e kontratës të mos jenë të përshtatura me kërkesat e projektit dhe të mos merret vlera për para.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që njësia kërkuese fillimisht të bëjë vlerësimin e nevojave për ekzekutim të punëve e pastaj të hartojë projektin (paramasën), po ashtu ndryshimet në pozicione të bëhen duke aplikuar procedurat e prokurimit.

Çështja A3 - Mos zbatimi i planit dinamik për realizimin e punimeve

Gjetja Nga testimi i tetë projekteve vërejtëm se në tri projekte kishte vonesa në realizimin e punëve si:

Në kontratat "Instalimi dhe sanimi i ndriçimeve publike (Shiroke, Sopiye, Mushtisht, Bllace, Studenqan dhe Samadraxhë) në vlerë 29,277€, e nënshkruar në shtator të vitit 2017, neni 1 i kontratës, citon se punët do të përfundojnë brenda 30 ditë, ndërsa kishin përfunduar në qershor të vitit 2018. Ky projekt kishte vonesa në realizim për tetë (8) muaj.

Kontrata për “Ndërtimin e rrugës Moholan – Stravuqin”- faza e parë në vlerë 7,135€ e nënshkruar në gusht të vitit 2018, neni 1 i kontratës, citon se punët do të përfundojnë brenda 60 ditë, ndërsa kishin përfunduar në dhjetor të vitit 2018, që do të thotë se kishte vonesa në realizim prej dy (2) muajve.

Sipas diskutimeve me organin mbikëqyrës këto kontrata nuk ishin realizuar me kohë për shkak se, para hartimit të projektit (paramasës) kryetarët e fshatrave nuk kishin marrë pëlqimin paraprak të banorëve, duke shkaktuar pastaj probleme pronësore nga ana e tyre.

Kontrata “Ndërtimi dhe renovimi i objekteve sportive dhe kulturore” në vlerë 47,247€, ishte nënshkruar në maj të vitit 2018, ndërsa sipas nenit 1 të kontratës, ishte paraparë që plani dinamik i punëve të përfundonte brenda 60 ditë. Për këtë projekt ishte nënshkruar edhe aneks kontratë në muajin korrik 2018, në nenin 2 të këtij aneksi citohet se punët duhet të përfundojnë brenda 15 ditëve. Punët për këtë projekt kanë përfunduar në tetor, që do të thotë se kishte vonesa në realizim prej dy (2) muajve.

Sipas diskutimeve me menaxherin e kontratës dhe organin mbikëqyrës, kjo kontratë nuk ishte realizuar me kohë për shkak të punëve shtesë, ndryshimeve të pozicioneve dhe për shkak të kushteve atmosferike.

Rreziku

Vonesat në realizimin e projekteve dhe hyrja në obligime kontraktuale pa analizuar mirë projektet dhe kushtet për kryerje të punëve, rrezikon tej zgjatjen e realizimit të projekteve. Po ashtu, mund të rezultojë me dështim të projektit dhe mos arritjen e objektivave komunale, duke ndikuar në proceset buxhetore të projekteve tjera.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontroleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative (marrjen e lejeve përkatëse) para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja C3 - Mangësi administrative në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Gjetja Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik (RrUOP) pika 20.8 përcakton se specifikimet teknike që referohen me marka tregtare janë të ndaluara. Në dosjen e tenderit për "Furnizim me toner për printer dhe fotokopje" kemi vërejtur se komuna ka përgatite specifika teknike duke përcaktuar se çfarë marke tregtare duhet ofertuar operatorët ekonomik.

RrUOP pika 39.8 specifikon se nëse autoriteti kontraktues (AK) duhet të dërgojë "kërkesë për sqarim të tenderit" operatori ekonomik duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek autoriteti kontraktues në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik. Te dosja e tenderit për kontratën "Ndërtimi i kanalizimit (segmente) në lagjen Sopa, Graishta dhe Lugu në Duhel" ishin kërkuar informata shtesë, meqë nuk ishte plotësuar tërësisht kriteri profesional, ku ndër kriteret ishte edhe sjellja e CV-së për inxhinier të ndërtimtarisë, ndërsa operatori ekonomik nuk i kishte sjellë sqarimet shtesë përmes sistemit elektronik.

Mos respektimi i kriterëve ka ardhur si pasojë e mos aplikimit të kontrolleve efektive nga zyra e prokurimit, duke specifikuar markat tregtare në dosje të tenderit dhe mos pranimit të dokumenteve shtesë përmes sistemit elektronik.

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit dhe mos specifikimi teknik i duhur, mund të rezultojë me trajtim dhe vlerësim jo të barabartë të ofertuesve. Për më tepër, në rast të ankesave nga OE, mund të vie deri te zgjatja e procedurave të prokurimit si dhe në realizimin me vonës, apo mos realizimin e projekteve.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë se në fushën e prokurimit janë duke u zbatuar kontrollet nga ana e zyrës së prokurimit, në këtë kontest, kriteret nuk duhet të përmbajnë marka të caktuara tregtare dhe kërkesat tjera të nevojshme të jenë të pranuar në formë elektronike sipas RrUOP, me qëllim të arritjes së synimeve për realizimin e mirëfilltë të kontratave.

Çështja B1 - Vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit e pamjaftueshme

- Gjetja** Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik (RrUOP), pika 30.6 specifikon se, siguria e ekzekutimit mbetet valide për një periudhë tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Për kontratën “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” në vlerë 15,509€” e nënshkruar për një periudhë një vjeçare, siguria e ekzekutimit e ofruar nga operatori ekonomik ishte vetëm gjashtë muaj, duke mos mbuluar kështu kohëzgjatjen e plotë të kontratës.
- Rreziku** Mangësitë e identifikuara rezultojnë me mos aplikimin e rregullave dhe mungesë të garancionit apo sigurisë për punët e pranuar. Në raste të dëmtimit të punimeve/mallrave në mungesë të garancionit, komuna mund të përballet edhe me shpenzime shtesë.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të vendos kontrole adekuate dhe monitorim të përshtatshëm për tu siguruar se zbatohen të gjitha kërkesat ligjore gjatë prokurimit dhe komuna aplikon garanci për tu siguruar se ekzekutimi punëve, mallrave apo shërbimeve bëhet në përputhje me marrëveshjet.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Vlera neto e pasurive kapitale në PFV në fund të vitit 2018 është 282,946€.

Çështja C4 - Menaxhimi jo i duhur i pasurive

Gjetja Përveç çështjes së cekur tek theksimi i çështjes, tek menaxhimi i pasurive kemi identifikuar se:

Për pasuritë jo financiare kemi bërë ekzaminimin fizikë të nëntë llaptopëve dhe 18 mobileve (tavolina, karrika, dollapë) të cilat ishin vështirë të identifikohen, sepse nuk ishin të pajisura me bar-kodet dhe numrat serik. Po ashtu, edhe regjistrimi i tyre në programin e-pasuria ishte i mangët sepse nuk ishin regjistruar me numra serik sipas rregullores MF -nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare (neni 6). Përveç kësaj, kishte mangësi në menaxhimin e pasurive jo financiare, meqë disa persona ishin ngarkuar me pasuri-pajisje që nuk i kanë nën menaxhimin e tyre, ndërsa personat që punonin me këto pajisje nuk janë të ngarkuar fare.

Sipas zyrtarëve komunal, shkak i këtyre parregullsive është mungesa e trajnimeve nga ana e Ministrisë së Administratës Publike për përdorimin e sistemit nga ana zyrtarëve përkatës, mos furnizimin me material për bar-kode. Mirëpo, kjo situatë ndikohet edhe nga neglizhenca për zbatimin e rregullores për regjistrimin e pasurive.

Rreziku Mungesa e evidencave të sakta rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Mos evidenca e saktë përmes bar-kodeve, numra serik dhe mos ngarkimi i personave me pajisje që kanë nën menaxhimin të tyre, mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin apo përdorimin e paautorizuar të pasurive.

Rekomandimi C4 Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollat lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të sigurojë regjistrim të saktë dhe të plotë të tyre. Po ashtu, të sigurojë trajnimet e domosdoshme për zyrtarët përkatës, që pasuritë të regjistrohen-plotësohen me informatat e nevojshme (barkode, nr. serik etj.) dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore duke ofruar transparence të plotë për përdoruesit.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore, varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Të arkëtueshmet

Komuna ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar përmes drejtorive përkatëse. Megjithatë, edhe më tutje sistemi i kontrollit duhet të forcohet, për të parandaluar rritjen e të arkëtueshme nga viti në vit dhe vlera e tyre të ulet në një shkallë të pranueshme.

Komuna e SuharekësPFV te vitit 2018 ka shpalosur llogari te arkëtueshme në vlerë 4,331,583€, në të cilat pjesëmarrje me të madhe kanë të hyrat nga tatimi në pronë me 60%, taksat e bizneseve në veprimtari 26% si dhe pjesa e mbetur nga të hyrat e dhënies së pasurisë të patundshme komunale me qira. Krahasuar me vitin e kaluar 4,047,000€ llogaritë e arkëtueshme ishin rritur për 284,583€.

Nga tatimi në pronë i faturuar për 2018 (duke përjashtuar arkëtueshmet e viteve paraprahe, kamatën dhe ndëshkimet) në vlerë prej 880,567€ € ishte mbledhur 673,627€ apo 76%.

Çështja B2 - Sfidat në menaxhimin e të arkëtueshmeve

Gjetja Në tetë kontrata për shfrytëzimin e pronës publike, identifikua se, për shkak të mos pagesës mujore apo vjetore nga qiramarrësit sipas kontratave, komuna nuk kishte arritur t'i arkëtojë të hyrat nga borxhi i akumuluar me vlerë totale prej 152,656€. Katër nga këto kontrata, ishin dhënë për periudhë afatgjate. Në nenin 3 të kontratave, ishte specifikuar që kontrata të ripërtërihet çdo vit për shkak të një monitorimi më të mirë, megjithatë këto kontrata nuk ishin ripërtërirë, ndërsa për dy kontrata tjera afati kohor i kontratave kishte skaduar. Komuna aktualisht kishte shpërndarë njoftimet dhe vërejtjet tek qiramarrësit që nëse nuk paguajnë borxhin do të merren masa ndaj tyre.

Pasojë e mos arkëtimit me kohë ishte mungesa e mekanizmave adekuat nga ana e komunës për t'i arkëtuar borxhet e mbetura.

Rreziku Skadimi i kontratave rezulton me parregullsi në mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave dhe komuna mund të humb të drejtën e arkëtimit të rregullt të të hyrave apo arkëtimit të të arkëtueshmeve në mungesë të një kontrate valide. Në anën tjetër, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.

Çështja A4 - Menaxhim jo efikas i të hyrave nga veprimtaritë e biznesit

Gjetja Komuna nuk ka menaxhim efikas për të hyrat nga veprimtaritë e biznesit. Në mungesë të komisioneve në teren për identifikimin e bizneseve të reja dhe atyre që janë pasive, komuna vazhdon t'i mbajë në regjistra. Si rezultat i kësaj, kishte raste që komuna kishte ngarkuar biznese vite me radhë, edhe pse ato biznese ishin të shuara. Kjo reflekton në rritjen e llogarive të arkëtueshme në baza jo reale. Vlera totale e të arkëtueshmeve nga veprimtaritë e biznesit është prej 1,113,214€.

Në disa raste, në bazë të disa kërkesave nga bizneset, komuna kishte fshirë obligimet e bizneseve të akumuluar vite me radhë, mirëpo nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme nëse zyrtarët e komunës kanë verifikuar gjendjen e këtyre bizneseve në teren. Ndërsa në një rast ishte bërë fshirja e obligimeve të akumuluar deri në vitin 2018, vetëm duke u bazuar nga një procesverbal të inspeksionit të lëshuar në vitin 2014, pa dëshmi të mjaftueshme, dhe pa formim të komisionit siç e parasheh rregullorja e komunës për tarifa¹⁰.

Rreziku Mungesa e komisioneve përkatëse për identifikimin e bizneseve pasive/të shuara apo të regjistruara rishtazi, rrit rrezikun për keq menaxhim në evidentimin dhe mbledhjen e të hyrave nga komuna.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive dhe ato të shuara çdo vit në mënyrë që të ketë një vlerësim të saktë të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmeve të akumuluar ndër vite. Për më tutje, fshirja e obligimeve të akumuluar për disa vite duhet të shqyrtohet në Kuvendin Komunal.

¹⁰ Rregullore për tarifat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale neni 5 pika 5.2.7, që të formohen komisioni dhe bizneset që kanë qarkullim zero të lirohen nga taksa në aktivitete.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 80,325€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Krahasuar me vitin e kaluar (63,355€), obligimet kanë shënuar rritje prej 16,970€.

Ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi në raportimin e obligimeve në MF. Ato janë raportuar në përputhshmëri me kërkesat e rregullores për raportimin e obligimeve të papaguara.

Çështja A5 - Menaxhimi jo efektiv i obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas Rregullës Financiare nr.01/2013/MF- shpenzimi i parave publike (Neni 37-pika1) të gjitha faturat organizata buxhetore duhet ti paguaj brenda 30 dite.

Krahasuar me vitin e kaluar, obligimet kanë shënuar rritje prej 16,970€. Si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, kishte raste kur pagesat për faturat e papaguara ishin ekzekutuar direkt sipas vendimeve të Gjykatës Themelore në vlerë 70,698€. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos pagesës me kohë të faturave/obligimeve.

Në 14 raste faturat/obligimet nuk ishin paguar sipas afatit ligjor prej 30 ditëve.

Ndërsa detyrimet kontingjente, në fund të vitit 2018 ishin 388,533€, krahasuar me vitin e kaluar (157,000€). Detyrimet kanë shënuar rritje prej 231,533€. Kjo rritje ishte për shkak se gjatë vitit 2018 kishte 10 lëndë të reja, dhe vlera e disa detyrimeve të vjetra ishte rritur.

Rreziku Dështimet e pagesave ndaj furnitorëve në afatet ligjore dhe rritja e obligimeve dhe detyrimeve kontingjente gjatë vitit 2018, rritë rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraprak. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari që njëkohësisht reflektohet me kosto shtesë.

Rekomandimi A5 Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet dhe detyrimet kontingjente të mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkaptujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse komuna ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme.

Këtë vit kishte një numër më të madh të zbatimeve të rekomandimeve, mirëpo ende zbatimi i rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake, mbetet sfidë e menaxhmentit, andaj duhet të marrin masa përmirësuese në këtë drejtim. Angazhime të kufizuara në menaxhimin e rreziqeve dhe kontrolle të kufizuara në menaxhimin dhe sigurimin e të dhënave, kërkojnë një kujdes të shtuar, me që të dhënat dhe ruajtja e të dhënave (sistemet e teknologjisë informative) menaxhohen vetëm nga kompanitë e kontraktuara.

Të gjitha komunat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna e Suharekës posedon vetëm planet urbanistike dhe hapësinore dhe planin e reagimit emergjent, ndërsa obligimet tjera, komuna pretendon t'i plotësojë në të ardhmen.

Komuna, kishte plotësuar pyetësin e vet-vlerësimit (pyetësi ishte mbështetur me dëshmi), mirëpo procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB. Megjithëkëtë, NjAB kishte planifikuar dhe realizuar shtatë auditime, duke përmbushur planin vjetor. NjAB, për vitin 2018 kishte dhënë gjithsej 73 rekomandime ku prej tyre ishin zbatuar 31 rekomandime, në proces ishin 32 rekomandime dhe të pazbatuara ishin 10 rekomandime.

Po ashtu, NjAB kishte raportor në Njësinë Qendrore Harmonizuese (NjQH-AB) për mënyrën se si funksionon NjAB në Suharekë duke përfshirë këtu realizimin e raporteve, numrin e rekomandimeve të dhëna si dhe sa prej tyre janë implementuar.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime për vitin 2018 (tre takime në muajin dhjetor dhe një në muajin shkurt 2019). Takimet e mbajtura brenda një muaji ishin për shkak se komiteti i auditimit ishte formuar me vonesë.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B3 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në veçanti në menaxhimin e shpenzimeve duke i klasifikuar në kode adekuate, proceseve të prokurimit, menaxhimin e pasurive jo financiare, si dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Komuna, ende nuk ka hartuar regjistrin e rreziqeve. Ajo, ka marrë iniciativë për të punuar në hartimin e regjistrit të rreziqeve, mirëpo ende nuk ka rezultate/veprime konkrete. Kjo përbën mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e rreziqeve.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 ka rezultuar me 14 rekomandime. Menaxhmenti kishte përgatitur një plan veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Aktualisht komuna përmes ndihmës së një projekti të USAID-it është duke punuar rreth mundësisë së zbatimit të rekomandimeve. Kryetari i komunës kishte në rend të ditës raportin e auditimit për vitin 2017 në Asamblenë Komunale.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit tonë, nga 14 rekomandime të dhëna gjashtë (6) rekomandim janë zbatuar, katër (4) rekomandime ishin zbatuar pjesërisht, një rekomandim i mbyllur dhe tre (3) rekomandimeve nuk ishin trajtuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikimit të opinionit dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të pasurive kapitale dhe shpalesjeve tjera.</p> <p>Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	<p>Këtë vit komuna kishte një menaxhim më të mirë të pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe shpalesjes së detyrimeve kontingjente.</p> <p>Megjithatë edhe këtë vit kemi theksim të çështjes tek opinionin sa i përket gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve dhe për pasuritë nën 1000€.</p>	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Procesi i buxhetit	Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në vitin 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë	Komuna kishte realizuar 95% të buxhetit të planifikuar, ndërsa ekzekutimi i buxhetit tek investimet kapitale ishte 90%.	Rekomandimi i zbatuar.

		të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.		
3	Të hyrat	Kryetari duhet të konfirmoj se procesi i verifikimit të pronave është duke u aplikuar bazuar në rregullat, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Azhurnimi i të dhënave për pronat e tatueshme nëpërmes verifikimit të 1/3 së pronës, rezulton me të hyra të sakta komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.	Komuna këtë vit kishte arritët nga 14,438 prona të verifikojë 6,706 prona, sipas ligjit të ri të tatimit në pronë komuna ka arritur ta bëjë verifikimin e pronave.	Rekomandimi i zbatuar.
4		Kryetari duhet të rishikojë funksionimin e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat nga tatimi në pronë vlerësohen dhe menaxhohen bazuar në rregulloret përkatëse.	Zyra e tatimit në pronë ka kërkuar nga MF-Departamenti i tatimit në pronën të bënë përmirësimin e katër zonave katastrale. Pritet nga MF të zbatohet.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
5		Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat vlerësohen sipas rregulloreve përkatëse.	Kontrollet në këtë fushë në këtë vit ishin më të mira, duke vlerësuar të hyrat sipas rregulloreve.	Rekomandim i zbatuar.
6	Menaxhimi i personelit	Kryetari duhet t'i rishikojë shkaqet për dobësitë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit, dhe të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore.	Procesi i procedurave të rekrutimit, ishin të duhura, transparente, konkurruese dhe në pajtim me kërkesat ligjore.	Rekomandim i zbatuar.
7	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik dhe kontrollet janë funksionale sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit.	Ndarja e detyrave gjatë procesit të prokurimit ishte sipas procedurave të rregullta të prokurimit publik.	Rekomandim i zbatuar.
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se në fushën e prokurimit janë duke u zbatuar kontrollet të cilat kanë për qëllim përmbushjen dhe vlerësimin profesional të kriterëve të vendosura, me qëllim të arritjes së synimeve për realizimin e mirëfilltë të kontratave.	Kriteret profesionale ishin plotësuar pjesërisht, për veç CV, e cila nuk ishte e bashkangjitur në sisteme elektronike.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
9	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe	Kryetari duhet të vendos kontrole adekuate dhe monitorim të përshtatshëm për tu siguruar se zbatohen të gjitha kërkesat ligjore gjatë prokurimit		Rekomandim i pazbatuar

	shërbimet si dhe investimet Kapitale	dhe komuna aplikon garanci për tu siguruar se ekzekutimi punëve, mallrave apo shërbimeve bëhet në përputhje me marrëveshjet.		
10	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të prioritetizoj kompletimin e një inventarizimi gjithëpërfshirës me qëllim të forcimit të kontrollit mbi vërtetimin e saktësisë dhe cilësinë apo gjendjen faktike të pasurisë. Gjithashtu ndryshimet e identifikuar të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrat e pasurisë.	Inventarizimi ishte bërë, megjithatë për shkak të mos regjistrimit të të gjitha pasurive në sistemin e e-pasurisë, nuk ka qenë e mundur të bëhet harmonizim me regjistrat.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
11	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduara bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.		Rekomandim i pazbatuar.
12	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Komuna në bashkëpunim me USAID ka monitoruar implementimin e rekomandimeve, me që këtë vit ka shënuar një përmirësim në implementimin e rekomandimeve ende kanë mbet rekomandime të pazbatuara.	Rekomandim i mbyllur.
13	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që KA mbanë takime të rregullta dhe në procesverbalet e takimeve nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.	Ishin mbajtur katër takime për vitin 2018, por takimet ishin mbajtur në fund vit me që komiteti i auditimit ishte themeluar me vonësë.	Rekomandim i zbatuar.
14	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin	Komuna, ka marrë iniciativë për të punuar në hartimin e regjistrit të rreziqeve, mirëpo ende nuk ka rezultate/ veprime konkrete.	Rekomandim i pazbatuar.

		e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.		
.Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1.	PFV	Kryetari duhet të siguroj që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën, të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike. Po ashtu, të konsideroj si prioritet çështjen e menaxhimit të pasurisë, përkatësisht regjistrimin e plotë të pasurisë, e cila do të reflektohet drejt edhe në paraqitjen e PVF.		
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të rishikojë funksionimin e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar, që të përditësohet me kohë sistemi nga zyrtaret e tatimit në pronë në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, që të dhënat në sistem lidhur me tatimin në pronë të azhurnohen të vlerësohen dhe menaxhohen bazuar në rregulloren e tatimit në pronë.		
3.	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj se, mallrat të cilat duhet të jenë të identifikuar me numër, serik, të përfshihen në fletë dërgesë/faturë dhe specifikat tjera të domosdoshme, për tu siguruar se është pranuar malli në pajtim me specifikat dhe çmimet e kontraktuara. Po ashtu të sigurojë se në përbërje të komisioneve të caktohet edhe ndonjë anëtarë ekspertë për fushën përkatëse dhe komisionet të përgatitin raporte për pranimin e mallit.		
4.	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që njësia kërkuese fillimisht të bëjë vlerësimin e nevojave për ekzekutim të punëve e pastaj të hartojë projektin (paramasën), po ashtu ndryshimet në pozicione të bëhen duke aplikuar procedurat e prokurimit.		
5.		Kryetari duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative (marrjen e lejeve përkatëse) para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.		
6.	Çështje të përbashkëta, mallra dhe shërbime dhe investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se në fushën e prokurimit janë duke u zbatuar kontrollet nga ana e zyrës së prokurimit, në këtë kontest, kriteret nuk duhet të përmbajnë marka të caktuara tregtare dhe kërkesat tjera të nevojshme të jenë të pranuar në formë elektronike sipas RrUOP, me qëllim të arritjes së synimeve për realizimin e mirëfilltë të kontratave.		
7.	investime kapitale	Kryetari duhet të vendos kontrolle adekuate dhe monitorim të përshtatshëm për tu siguruar se zbatohen të gjitha kërkesat ligjore gjatë prokurimit dhe komuna aplikon garanci për tu siguruar se ekzekutimi punëve, mallrave apo shërbimeve bëhet në përputhje me marrëveshjet.		
8.	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të sigurojë regjistrim të saktë dhe të plotë të tyre. Po ashtu, të sigurojë trajnimet e domosdoshme për zyrtarët përkatës, që pasuritë të regjistrohen-plotësohen me informatat e nevojshme (barkode, nr. serik etj.) dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore duke ofruar transparence të plotë për përdoruesit.		
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.		

10.		Kryetari duhet të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive dhe ato të shuara çdo vit në mënyrë që të ketë një vlerësim të saktë të llogarive të arkëtueshme. Poashtu të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmeve të akumuluarra ndër vite. Për më tutje, fshirja e obligimeve të akumuluarra për disa vite duhet të shqyrtohet në Kuvendin Komunal.
11.	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet dhe detyrimet kontingjente të mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve.
12.	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk

ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF
SUHAREKA



ZYRAE KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-26473

Me date: 05.04.2019

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

LETËR E KONFIRMIMIT

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ

